



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 843 prot.

Tiranë, më 30. 04. 2026

V E N D I M

Nr. 112, datë 30. 04. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shqyrtoi ankesën nr. 240 Regj., datë 20.10.2025, e subjektit ankues J. M., përfaqësuar pranë Komisionerit nga D. N., kundër Palestrës Ladies Gym², me pretendimin për diskriminim, për shkak të “identitetit gjinor” dhe “orientimit seksual”³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Më 16 tetor, më është mohuar hyrja në palestër. Kur kërkova një shpjegim, A. K., pronari i palestrës, më tha qartë se refuzimi kishte ndodhur për shkak të orientimit tim seksual. Nuk jam rezidente, por po e frekuentoja palestrën në të njëjtat kushte si vizitorët dhe mysafirët e tjerë që lejoheshin të hynin pa asnjë kufizim. Z. dhe T., të cilat janë rezidente ligjore dhe shtetase amerikane, u lejuan ta përdornin palestrën pa asnjë problem, gjë që tregon se refuzimi ndaj meje nuk bazohej në ndonjë rregull apo kërkesë legjitime. Jam veçuar vetëm për shkak të orientimit tim seksual, ndërkohë që të tjerët në rrethana të njëjta u lejuan të hynin. Kjo përbën diskriminim mbi bazën e orientimit seksual dhe është faktikisht i pajustificuar”⁴.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të saj për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual nga ana e Palestrës Ladies Gym, Tiranë dhe:

- Rivendosja e aksesit për lejimin e saj të kthehet në palestër dhe të përdorë të gjitha pajisjet pa asnjë kufizim ose pengesë të mëtejshme.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² NUIS L.....T.

³ Referuar pretendimeve të përshkruara në ankesë, ankuesja pretendon se i përket komunitetit LGBTI.

⁴ Përkthim i Komisionerit.

- Trajnimin e administratorit, A. K., së bashku me të gjithë stafin, mbi respektimin e diversitetit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.
- Vendosjen e materieleve informuese në ambientet e palestrës, sa i përket ndalimit të diskriminimi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në referencë të kësaj dispozite ligjore, rezulton se shkaqet e pretenduara nga ankuesja, *identiteti gjinor dhe orientimi seksual*, janë shkaqe të mbrojtura, sipas nenit 1, të LMD.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), mbrojtja nga diskriminim garantohej *ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë*, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Neni 4, pika c, i LMD, parashikon se: *“1. Ky ligj zbatohet për sektorin publik dhe privat duke përfshirë edhe institucionet publike, si dhe të gjithë personat, përfshirë, por pa u kushtëzuar në: ... c) shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim apo vendqëndrim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe personat fizikë apo juridikë të huaj me aktivitet apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë mbrojtjen që ofron ky ligj në marrëdhënie me autoritetet publike ose personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtari në sektorin publik ose privat, që ndodhet nën juridiksionin shqiptar”.*

LMD, garanton mbrojtje nga diskriminimi në fushën e shërbimeve. Në nenin 20, pika 1, germa a, të LMD, sanksionohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të ligjit.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1469/2 prot., datë 13.11.2025, Komisioneri njoftoi palët, për fillimin e procedurës administrative, duke kërkuar parashtrime dhe informacion në lidhje me çështjen nga ana e Palestra Ladies Gym, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Në përgjigje përsa më lart, Palestra Ladies Gym, përmes shkresës⁵ datë 11.12.2025, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: “...Në vlerësimin tonë, ankesa e paraqitur nga shtetasja J. M. nuk përfaqëson një pretendim të sinqertë për mbrojtje të një të drejte, por një viktimizim të qëllimshëm, i cili ka sjellë cenim të padrejtë ndaj integritetit, reputacionit dhe ushtrimit të ligjshëm të aktivitetit të palestrës “Ladies Gym”. Përmbajtja e ankesës, e shoqëruar me publikime denigruese në platforma online, krijon jo vetëm një imazh të rremë mbi shërbimin tonë, por përbën një ndërhyrje të rëndë dhe të pajustificuar në të drejtat dhe interesat e një subjekti ekonomik që ka respektuar çdo standard ligjor dhe etik në ofrimin e një shërbimi të specializuar dhe të ndjeshëm për gra.

Ky viktimizim i pavërtetuar, i ngritur mbi një narrativë të ndërtuar pas konsumimit të shërbimit, synon të imponojë pabarazi të padrejtë dhe të delegjitimojë masat teknike të mirëfillta të menaxhimit të kapacitetit, masa që janë të domosdoshme për funksionimin korrekt, të sigurt dhe me privatësi të ambientit tonë. Palestra nuk mund të pranojë që një pretendim i pabazë të kthehet në mjet presioni, aq më pak kur ai përdoret për të cenuar reputacionin dhe marrëdhënien e ndershme me qindra gra që prej vitesh besojnë cilësinë e shërbimit tonë.

Jemi realisht të befësuar dhe të shqetësuar nga përmbajtja e shkresës, e cila përbën vijim të një cenimi të padrejtë të integritetit dhe reputacionit të palestrës “Ladies Gym”. Menjëherë pas marrjes së njoftimit, duke qenë se administratori nuk ndodhej në territorin e Republikës së Shqipërisë, kryem verifikim të detajuar të regjistrave të frekuentimit dhe komunikimeve të stafit, për të konstatuar saktësisht se për cilin individ bëhej fjalë. Nga verifikimet rezultoi se shtetasja J. M. ka qenë e pranishme në ambientet e palestrës sonë dhe është lejuar të frekuentojë shërbimin si çdo vizitore tjetër, pa asnjë kufizim apo trajtim të diferencuar në prezencën e saj.

Palestra “Ladies Gym” operon prej vitesh si një shërbim i specializuar për gra, me reputacion të konsoliduar dhe me një strukturë të veçantë shërbimesh të avancuara. Një pjesë e anëtareve tona janë kliente fikse, të abonuara me trajnim personal profesional, për të cilat ofrohen programe të individualizuara dhe shërbime jashtë formatit standard të përdorimit të ambientit. Për këtë kategori

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1479/2 prot., datë 11.11.2025.

klientesh ekziston një kufizim i domosdoshëm numerik, i lidhur me kapacitetin real të hapësirave dhe mundësisë së trajnerit A. K. për tu shërbyer klienteve.

Pikërisht për këto arsye, në momentet kur ka mbingarkesë dhe kur nga klientet ekzistuese paraqiten ankesa të arsyeshme për tejkalimin e kapacitetit çka ka ndodhur edhe në rastin konkret palestra zbaton rregullin standard të brendshëm: përdorueseve të regjistruara së fundmi u komunikohen oraret alternative më të përshtatshme për frekuentim, për të garantuar ekuilibrin e shërbimit. privatësinë dhe komoditetin e çdo grupaje që frekuenton ambientet tona.

Në këtë kuadër, ankueses njësoj si çdo përdorueseje tjetër të regjistruar në atë periudhë i është sqaruar se në oraret e pikut, ku ushtrojnë kryesisht anëtarët e vjetra të abonuar dhe ku trajnimi zhvillohet nën mbikëqyrjen e trajnerëve personalë, limitet fizike të hapësirës nuk lejonin shtimin e përdorueseve të reja. Nisur nga regjistri i frekuentimit, i është komunikuar në mënyrë të sjellshme dhe transparente se oraret më të qeta dhe më të përshtatshme janë ditët e hënë, të martë dhe të enjte, nga ora 13:30 deri në ora 15:00 fashë orare në të cilën fluksi është dukshëm më i ulët. Ky komunikim është masë teknike, e diktuar nga kapaciteti fizik, dhe asnjëherë nuk ka patur apo mundur të ketë lidhje me identitetin e saj gjinor.

Theksojmë gjithashtu se, pavarësisht këtij trajtimi krejtësisht të rregullt, ankuesja ka publikuar komente të pavërteta dhe denigruese në platformën Google Maps, të cilat kanë cenuar padrejtësisht figurën dhe integritetin profesional të palestrës sonë, duke krijuar një perceptim të shtrembëruar për shërbimin që ne ofrojmë. Ky akt përbën një vijim të qasjes së saj viktimizuese dhe ndërhyrje të pajustificuar në reputacionin e një subjekti që ka respektuar në mënyrë shembullore standardet ligjore dhe etike të ushtrimit të aktivitetit.

Në vlerësimin e këtij rasti, neni 20 i Ligjit nr. 10221/2010 është vendimtar, sepse përcakton situatat kur dallimet në trajtim nuk përbejnë diskriminim. Së pari, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk ka diskriminim kur subjekti i akuzuar provon se veprimi i tij është mbështetur në arsye objektive, që nuk lidhen me cilësitë e mbrojtura të individit. Në rastin konkret, kufizimi i komunikimit me ankuesen ka qenë i bazuar tërësisht në një rrethanë faktike dhe të verifikueshme: kapacitetin e tejkualuar të ambienteve të zhveshjes dhe banjove, si dhe politikën e brendshme të palestrës për menaxhimin e fluksit në periudha mbingarkese. Këto elemente janë objektive dhe të paanshme, duke përjashtuar çdo lidhje me identitetin gjinor të ankueses.

Së dyti, pika 5 e nenit 20 parashikon se dallimet në trajtim nuk konsiderohen diskriminuese kur janë të arsyeshme, proporcionale dhe të lidhura me një rrezik real. Në këtë rast, rreziku i mbipopullimit të ambienteve të zhveshjes i cili mund të cenojë privatësinë. komoditetin dhe kushtet higjieno-sanitare është rrezik faktik dhe i vërtetueshëm. Masa e marrë nga palestra është masa më e butë dhe më proporcionale e mundshme: orientimi i përdorueseve të regjistruara së fundmi drejt orareve alternative, jo ndalim i shërbimit. Pikërisht kjo e bën masën të ligjshme dhe të justifikuar në kuptimin e ligjit.

Së treti, pika 7 e nenit 20 lejon kufizime të arsyeshme kur ato synojnë mbrojtjen e të drejtave të tjerëve dhe kur janë të bazuara në kritere objektive. Në këtë rast, palestra ka vepruar për ruajtje të drejtat dhe komoditetin e anëtareve të vjetra me abonime 10 vjeçare, të cilat frekuentojnë ambientet në oraret e pikut dhe kanë një pritshmëri të ligjshme për hapësira në palestër komoditet në përdorimin e çdo ambienti privatësi dhe siguri gjatë frekuentimit të palestrës.

Politika e brendshme për orientimin e përdorueseve të regjistruara së fundmi në orare jo të pikut është një masë e arsyeshme, e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme për mbarëvajtjen e shërbimit.

Duke u bazuar në nenin 20, rezulton se mungon lidhja shkakësore ndërmjet identitetit gjinor të ankueses dhe komunikimit që i është bërë nga stafit i palestrës. Kufizimi ka qenë teknik, objektiv, proporcional dhe i aplikuar në mënyrë të njëjtë për çdo përdoruese të regjistruar në të njëjtën situatë. Për rrjedhojë, nuk plotësohet asnjë element i domosdoshëm për të konstatuar diskriminim, dhe masa e marrë nga palestra është plotësisht e ligjshme dhe në përputhje me standardet e nenit 20 të ligjit.

Palestra "Ladies Gym" ofron një shërbim të specializuar ekskluzivisht për gra, model i cili është ligjërish i lejuar dhe i njohur gjerësisht në praktikën europiane, sidomos në rastet kur privatësia, siguria dhe komoditeti i grave në ambientet e palestrës përbëjnë një qëllim të ligjshëm dhe të domosdoshëm për funksionimin korrekt të aktivitetit. Duke qenë se ambientet e palestrës janë hapësira veçanërisht të ndjeshme, ruajtja e integritetit dhe privatësisë së përdorueseve është detyrim i vetë ofruesit të shërbimit, duke justifikuar plotësisht masat e përkohshme të menaxhimit të fluksit kur kapaciteti është i tejkaluar.

Në këtë rast, kërkesa e bërë ndaj ankueses për të frekuentuar palestrën në orare alternative nuk përbën diskriminim, pasi masa është, teknike dhe e përgjithshme, e zbatuar në mënyrë të njëjtë për çdo përdoruese të regjistruar të cilës i komunikohet se cilat janë fashat orare të mbingarkesës. Kjo masë e marrë nga palestra është e arsyeshme, e domosdoshme dhe e përshtatshme, dhe është marrë me qëllim të qartë për të shmangur tejmbushjen e ambienteve, duke mbrojtur të drejtat e përdorueseve të tjera të cilat frekuentojnë palestrën në oraret e pikut. Nuk ka asnjë fakt apo veprim që të tregojë se kjo masë është marrë për shkak të identitetit gjinor të ankueses.

Punonjësit e palestrës, në asnjë moment, nuk kanë pasur dijeni apo ndonjë indicie lidhur me identitetin gjinor të ankueses dhe nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë dallime të kësaj natyre. Komunikimi i stafit ka qenë strikt i kufizuar tek çështjet operative të palestrës, konkretisht menaxhimi i kapacitetit në oraret e pikut dhe nuk është bërë asnjë pyetje, vërejtje apo koment që të lidhet me gjininë, identitetin gjinor apo ndonjë cilësi tjetër të mbrojtur të ankueses. Kjo tregon qartë se masa e komunikuar nuk ka qenë dhe nuk ka mundur të jetë e motivuar nga identiteti i saj, përderisa ai nuk ka qenë i njohur për stafin. Në mungesë të dijenisë dhe të çdo elementi subjektiv që mund të lidhej me identitetin e ankueses, është juridikisht e pamundur të ekzistojë trajtim i pabarabartë i bazuar në këtë cilësi.

Gjithashtu, në aplikim të testit të proporcionalitetit, rezulton se:

- *qëllimi ka qenë legjitim;*
- *masa është më e buta dhe më e drejtë e mundshme (orientimi i orareve, jo ndalim i shërbimit);*
- *masa ka qenë absolutisht e domosdoshme në kushtet e kapacitetit të tejkaluar;*
- *dhe është zbatuar në mënyrë të barabartë dhe pa përjashtim ndaj çdo përdorueseje.*

Për rrjedhojë, nga analiza faktike dhe juridike, rezulton se:

- *ankuesja nuk është trajtuar ndryshe nga të tjerët për shkak të orientimit seksual;*
- *masa ka qenë e bazuar në arsye objektive dhe jo në identitetin e saj;*
- *nuk ekziston asnjë element dallimi apo preferimi;*
- *dhe në mungesë të lidhjes shkakësore ndërmjet cilësive të mbrojtura dhe komunikimit të bërë, nuk plotësohet asnjë kriter i nenit 20 të Ligjit 10221/2010.*

Në këto kushte, veprimi i palestrës është plotësisht ligjor, proporcional dhe i paanshëm. Për rrjedhojë, kërkojmë mbylljen e procedimit administrativ dhe moskonstatimin e çdo forme diskriminimi.

Në përfundim, duke vlerësuar se pretendimet e pavërtetuara të ankueses dhe publikimet e saj në platforma online, përfshirë Google Maps, kanë cenuar drejtpërdrejtë reputacionin dhe figurën profesionale të palestrës “Ladies Gym”, njoftojmë se subjekti ynë do të ndër marrë çdo masë administrative dhe ligjore të parashikuar për mbrojtjen nga dëmet e shkaktuara nëpërmjet deklaramëve të pavërteta, denigruese dhe viktimizuese. Palestra rezervon të drejtën ti drejtohet organeve kompetente për vlerësimin e përgjegjësive civile dhe penale që burojnë nga shpifja. publikimi i informacionit të rremë dhe dëmtimi i qëllimshëm i reputacionit të subjektit tonë. ”.

2. Komisioneri përmes e-mail-it datë 19.12.2025, i përcolli përfaqësueses së subjektit ankues, D. N. një kopje të shkresës së Palestrës Ladies Gym, si dhe kërkoi parashtrime me shkrim nga ana e saj. Sakaq, nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit asnjë përgjigje.
3. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenin 40, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)⁶”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 116 prot., datë 13.01.2026, ftoi palët në proces të merrnin pjesë për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre, në seancën dëgjimore datë 09.02.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datë 09.02.2026, me pjesëmarrjen e palës ankuese, J. M. dhe përfaqësueses së saj, D. N. Gjithashtu në seancë mori pjesë edhe përfaqësuesi i subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, A. K.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan parashtresave me shkrim të depozituara paraprakisht pranë Komisionerit. Ndër të tjera përfaqësuesja e subjektit ankues parashtroi ndër të tjera se: “...J. M., shtetase amerikane, e gjinisë femër, rezidente në Tiranë ka qenë anëtare e Palestrës Ladies Gym, subjekt ndaj të cilit është paraqitur kjo ankesë, ku ishte regjistruar dhe kishte ushtruar aktivitet për disa ditë, rregullisht.

Më datë 16.10.2025, gjatë ushtrimit të aktivitetit sportiv në ambientet e palestrës, J. M. u njoftua nga administratori i palestrës, përmes një mesazhi të përkthyer në telefonin e tij, se “disa kliente kishin shprehur kundërshtim ndaj pranisë së një “personi gay” në palestër” dhe për këtë arsye, ajo “nuk do të mund të frekuentonte më ambientet e palestrës”. Në të njëjtën kohë, i është rimbursuar edhe pagesa mujore e anëtarësisë.

Pas kësaj ngjarjeje, ajo ka komunikuar me dy miket e saj: T. B. dhe Z. M., me të cilat bashkëfrekuentonte rregullisht palestrën. Nisur nga komunikimi që B. dhe M. kishin me administratorin e palestrës, ato janë takuar personalisht me të për t'i kërkuar shpjegime lidhur me përjashtimin e J. M.. Ky takim është regjistruar në një material video, që paraqitet formalisht si material provues në kuadër të kësaj ankese.

Gjatë bisedës së regjistruar, administratori i palestrës ka thënë shprehimisht se:

- disa kliente (jo vetëm një, por tre ose katër) nuk e dëshironin praninë e J. M. në palestër;

⁶ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

- ai personalisht nuk kishte kundërshtime ndaj saj dhe kishte verifikuar dokumentin e identifikimit, ku ajo regjistrohet si femër;
- vendimi për moslejimin e saj në palestër ishte marrë për shkak të frikës së humbjes së klientëve të tjerë dhe interesit ekonomik, duke deklaruar se “do të humb klientë” dhe se “money is money”.

Këto deklarime të administratorit tregojnë qartë se përjashtimi i J. M. nga shërbimi i ofruar publikisht nga palestra nuk lidhet me ndonjë sjellje të saj, shkelje rregullash apo arsye objektive organizative, por është pasojë e drejtpërdrejtë e kundërshtimit të klienteve të tjera ndaj saj, për shkak të perceptimit mbi orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor dhe pamjen e saj.

Në këto rrethana, rezulton se J. M. i është refuzuar në mënyrë faktike aksesimi dhe ofrimi i një shërbimi me pagesë të ofruar për publikun, që nga momenti i komunikimit fillestar me administratorin e palestrës, që u pasua nga kthimi i pagesës mujore të abonimit...”

Pasi A. K. u vu në dijeni të videoregjistrimit të sipërcituar në parashtrimet e përfaqësueses së J. M., pranoi se ishte shprehur në atë mënyrë dhe menjëherë gjatë seancës kërkoi ndjesë për situatën e krijuar. Në vijim, A. K. i ofroi ankueses të jetë pjesë dhe të frekuentojë Palestrën Ladies Gym, pa asnjë kufizim apo trajtim të diferencuar.

Sa i përket propozimit të bërë nga ana e A. K., J. M. nuk pranoi të rikthehej në ambientet e Palestrës Ladies Gym dhe kërkoi nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin lidhur me situatën e ndodhur.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, J. M., shtetase amerikane, e gjinisë femër, rezidente në Tiranë ka qenë frekuentuese dhe anëtare e Palestrës Ladies Gym, ku ishte regjistruar dhe kishte ushtruar aktivitet për disa ditë, rregullisht.

Më datë 16.10.2025, gjatë frekuentimit të palestrës, J. M. është njoftuar nga administratori i palestrës, A. K., përmes një mesazhi të përkthyer në telefonin e tij, se “disa kliente kishin shprehur kundërshtim ndaj pranisë së një “personi gay në palestër” dhe për këtë arsye, ajo “nuk do të mund të frekuentonte më ambientet e palestrës”. Pas këtij momenti, ankueses i është rimbursuar edhe pagesa mujore e anëtarësisë.

Pas kësaj ngjarjeje, ajo ka komunikuar me dy miket e saj: T. B. dhe Z. M., me të cilat frekuentonte rregullisht palestrën. T. B. dhe Z. M. ishin takuar personalisht me administratorin e palestrës, për t’i kërkuar shpjegime lidhur me përjashtimin e J. M. Këtë takim ato e kanë regjistruar përmes një telefoni, në një material video.

Sipas bisedës së regjistruar, pranuar gjatë seancës edhe nga ana e A. K., rezultoi që ai është shprehur ndër të tjera se:

- disa kliente (jo vetëm një, por tre ose katër) nuk e dëshironin praninë e J. M. në palestër;

- ai personalisht nuk kishte kundërshtime ndaj saj dhe kishte verifikuar dokumentin e identifikimit, ku ajo regjistrohet si femër;
- vendimi për moslejimin e saj në palestër ishte marrë për shkak të frikës së humbjes së klientëve të tjerë dhe interesit ekonomik, duke deklaruar se “do të humb klientë” dhe se “money is money”.

Rezulton se në rastin konkret, ankueses i është refuzuar në mënyrë faktike mundësia për të vazhduar të përdorë shërbimin, kur i është kërkuar të mos shkojë më në palestër dhe i janë kthyer mbrapsht paratë e abonimit mujor. Përjashtimi i saj nga ambientet e Palestrës Ladies Gym, rezulton të jetë i pranuar edhe nga ana e administratorit të saj, A. K..

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja, J. M., i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe më pak të favorshëm nga ana e ofruesit të shërbimit/Palestra Ladies Gym.

B. Shkaku i mbrojtur

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2, 3)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shkakun e pretenduar nga subjekti ankues, atë të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Në nenin 1, të LMD sanksionohet se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtetësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pala ankuese pretendon se është diskriminuar për shkak të *identitetit gjinor dhe orientimit seksual*. Komisioneri konstaton se shkak i pretenduar nga ankuesja parashikohet shprehimisht si shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD.

Referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimit, rezulton se, përjashtimi “de facto”, i nga Palestra Ladies Gym, ka ardhur për shkak se disa kliente nuk dëshironin praninë e J. M. në palestër, duke hamendësuar lidhur me orientimin e saj seksual dhe identitetin gjinor. Në këto kushte, administratori, i vënë nën presionin e klienteve, i ka kërkuar ankuses largimin nga palestra për shkak të “identitetit gjinor të supozuar” nga klientet.

*Identiteti gjinor*⁷ lidhet me përvojën individuale e të brendshme të ndjerë të një personi në lidhje me gjininë, e cila mund të korrespondojë ose jo me gjininë e caktuar me lindjen e tij, duke përfshirë ndjenjën personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes ose funksionit trupor me anë të mjeteve mjekësore, kirurgjike ose mjeteve të tjera) dhe shprehje të tjera të gjinisë, duke përfshirë veshjen, të folurën dhe sjelljen.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi si dhe standardet dhe rregullimet ligjore në fuqi, Komisioneri vlerëson se, në asnjë moment apo rast, nga J. M. nuk është deklaruar apo pohuar tek stafi i palestrës lidhur me orientimin e saj seksual apo identitetin gjinor.

Pra, edhe pse ajo nuk ka deklaruar tek stafi i palestrës identitetin gjinor apo orientimin seksual, sipas përcaktimit të LMD-së, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, “identiteti gjinor i perceptuar” i J. M., si i tillë nga ana e klienteve dhe administratorit, A. K.⁸ (pasi pasojat, përjashtimi nga palestra i ka ardhur pikërisht mbi bazën e këtij perceptimi, marrë si të mirëqenë nga ana e administratorit të palestrës), do të pranohet si shkak i mbrojtur nën ombrellën e garancisë ligjore sa më sipër analizuar.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se shkaqet e pretenduara të diskriminimit të *identitetit gjinor dhe orientimit seksual*, përbëjnë shkaqe të mbrojtura/të ndaluara nga diskriminimi dhe se faktet dhe provat provojnë se ankuesja i mbart këto shkaqe.

⁷ Webi zyrtar i KMD-së - <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁸ Drejtueses së tij, në tagrin e autoritetit përfaqësues.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor në përputhje me standardet evropiane. Brenda këtij konteksti, Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe nënligjor të përparuar që adreson çështjet e të drejtave të njeriut në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përlligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese).

Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr. 19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 17, i Kushtetutës, përcakton se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.*

Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 16/1, i Kushtetutës së Shqipërisë, sanksionon se, *të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëllor edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”.*

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor⁹.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...”

Mbështetur në nenin 17, të Kushtetutës, *Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja)*, zë një vend të veçantë në hierarkinë e normave juridike.

Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një*

⁹ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Për më tepër, Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi bazën e orientimit seksual ose identitetit gjinor, kërkon që shtetet anëtare të sigurojnë qasje të barabartë në fushën e shërbimeve. Ky rekomandim thekson detyrimin e shteteve anëtare, ndër të cilat Shqipëria, për të garantuar që institucionet edukuese të jenë ambiente të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, duke ndaluar çdo formë përjashtimi ose trajtimi të pabarabartë për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Në bazë të garancive kushtetuese të ofruara nga nenet 18 dhe 54, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çdo shtetas është i barabartë përpara ligjit, nuk mund të diskriminohet pa një përlligje të arsyeshme dhe objektive dhe gëzon të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Në bazë të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të

arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit mes mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁰ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara¹¹”.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga paditësi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ do t'i pranojë ato si të provuara, përveçse kur i padituri paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ shprehet se: “... niveli i bindjes së nevojshme për arritjen e një përfundimi të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarjen e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën në rrezik.¹²”.

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: “...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga (viktima e diskriminimit) te (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të

¹⁰ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹¹ GJEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

¹² GJEDNJ Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se trajtimi nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese...”

Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë të kundërtën.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹³

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun e mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

¹³https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga subjekti ankues duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime *“të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht¹⁴”*.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues:

Së pari, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se pala ankuese, J. M. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Palestrës Ladies Gym.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë dhe i pafavorshëm i subjektit ankues, nga ana e Palestrës Ladies Gym, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Për sa më sipër, mbështetur në provat dhe faktet e administruara, KMD vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e Palestrës Ladies Gym, kundrejt subjektit ankues, dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Komisioneri vlerëson se, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (*diskriminimi prima facie*) se në pamje të parë ankuesja është diskriminuar për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, nga ana e administratorit të Palestrës Ladies Gym, pasi rezultoi e provuar dhe pranuar nga palët në proces se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme lidhur me përjashtimin e saj de facto nga Palestrës Ladies Gym, dhe se ky trajtim është bërë në mënyrë të pajustificuar objektivisht dhe ligjërisht.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁵, Komisioneri vlerëson se ankuesja, J. M., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e administratorit të Palestrës Ladies Gym, i cili përmes veprimeve konkludente të tij, e ka përjashtuar atë nga Palestra, në raport me të drejtën e saj ligjore për tu trajtuar me barazi dhe mosdiskriminim.

Subjekti ankues ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e administratorit të Palestrës Ladies Gym.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi i provuar e dokumentuar fakti që ankuesja e mbart shkakun e pretenduar, argumentuar në pjesën B, të Vendimit.

¹⁴ GJEDNJ, Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (GC) paragrafi 147, (ECtHR, Nachova and others v. Bulgaria [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, Timishev kundër Rusisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, Timishev v. Russia (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

¹⁵ Shih Ndarjen III, nëndarja A.1, të vendimit të KMD.

Posedimi i shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pakundërshtuar nga ana e administratorit të Palestrës Ladies Gym, për faktin se përjashtimi i saj de facto ka ardhur përmes veprimeve konkludente të drejtuesit të Palestrës, i cili ka pranuar edhe gjatë realizimit të seancës dëgjimore pranë Komisionerit, se i është kërkuar ankueses largimi nga Palestra për shkak të ankesave të klienteve të tjera të cilat kanë kërkuar një gjë të tillë për shkak të orientimit seksual.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e Palestrës Ladies Gym, u arrit të provohej që trajtimi i pafavorshëm dhe i diferencuar i ankueses nga ana e administratorit të Palestrës, ka ardhur për shkaqet e mbrojtura dhe të pretenduara nga ankuesja, si dhe prezumimit të identitetit gjinor dhe orientimit seksual të ankueses nga ana e klienteve.

Gjithashtu mbështetur në provat dhe informacionin e administruar, Komisioneri konkludon se nuk mund të jetë argument për përjashtimin e ankueses nga e drejta për të përdorur shërbimin e ofruar nga palestra, fakti që janë paraqitur ankesa nga disa kliente të saj.

Komisioneri thekson faktin se, identiteti dhe shprehja gjinore nuk lidhen në asnjë moment me seksualitetin e dikujt, por vetëm me perceptimin që një person ka ndaj gjinisë së tij respektive, dhe se, do të duhet që në një subjekt që ofron të mira dhe shërbime për publikun e gjerë të mos jetë përkrahës i stereotipeve gjinore të supozuara nga klientët e tij. Pamja e jashtme e një personi dhe mënyra se si zgjedh të vishet apo sillet, nuk ka pse të ndjekë stereotipet gjinore.

Sakaq, Komisioneri vlerëson se paragjykimet sociale dhe qëndrimet homofobe, qofshin ato të personit që ofron shërbimin apo të palëve të treta, nuk mund të shërbejnë si argument për të justifikuar mohimin ose kufizimin e shërbimeve ndaj një personi mbi bazën e identitetit gjinor ose orientimit seksual të tij.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka pohuar në mënyrë të qëndrueshme se diskriminimi i bazuar në orientimin seksual kërkon arsye veçanërisht serioze e bindëse si justifikim, dhe se diferencimet e motivuara vetëm nga konsiderata të orientimit seksual janë krejt të papranueshme sipas Konventës (*Karner kundër Austrisë, Nr. 40016/98, 24 korrik 2003, §§ 37, 41; Smith dhe Grady kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 33985/96 dhe 33986/96, 27 shtator 1999, § 90*). GJEDNJ ka qartësuar se diskriminimi është më i vështirë të justifikohet për disa shkaqe, dhe kur bëhet fjalë për orientimin seksual, Gjykata kërkon arsye veçanërisht serioze për të justifikuar çdo diferencim trajtimi¹⁶.

Homofobia, si formë e paragjykimit të bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor të një personi, nuk përbën justifikim të ligjshëm, as kur manifestohet si qëndrim personal i ofruesit të shërbimit dhe as kur buron nga presioni i klientëve të tjerë apo opinionit publik. Mesazhet paragjyquese fitojnë besueshmëri, me pasojën e diskriminimit, dhe madje edhe të dhunës, ndaj grupeve të minoriteteve, dhe për rrjedhojë nuk meriton të mbrohen¹⁷. Ky parim, i pohuar nga GJEDNJ në çështjen *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë* (Nr. 1813/07, 9 shkurt 2012), mbart

¹⁶ <https://www.coe.int/en/web/echr-toolkit/linterdiction-de-la-discrimination>

¹⁷ <https://www.interights.org/vejdeland/index.html>

rëndësi të drejtpërdrejtë jo vetëm në çështjet e lirisë së shprehjes, por edhe në çdo situatë ku qëndrimet homofobike shërbejnë si mbështetje për veprime diskriminuese.

GJEDNJ ka ripohuar parimin se diskriminimi i bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor është po aq serioz sa diskriminimi i bazuar në racën, origjinën ose ngjyrën¹⁸. Duke u bazuar mbi këtë parim, Komisioneri konsideron se bindja ndaj presioneve homofobe të palëve të treta nuk përbën qëllim legjitim dhe as nuk mund të shërbejë si justifikim proporcional, por vetë tejçon dhe fuqizon diskriminimin. Lejimi i klientëve të tjerë të diktojnë se cilët persona mund të kenë akses në shërbime publike, mbi bazën e identitetit gjinor ose orientimit seksual të tyre, do të kishte si efekt normalizimin e paragjytimeve homofobe dhe legjitimitimin e tyre si bazë vendimmarrjeje, diçka që bie ndesh tërësisht me qëllimin e LMD-së dhe me standardet europiane të të drejtave të njeriut.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, është pikërisht sjellja e administratorit të Palestrës shkaku determinant dhe i vetëm i largimit të ankueses nga Palestra Ladies Gym.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i diferencuar dhe i pafavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, si dhe është tërësisht i papërligjur në fakte, prova e dispozita ligjore.

Gjithashtu, praktika gjyqësore¹⁹ e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka përcaktuar se diskriminimi mbi bazën e identitetit gjinor ose shprehjes gjinore është i ndaluar sipas nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenin 10 (liria e shprehjes).

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se administratori i Palestrës Ladies Gym, A. K., e ka trajtuar në mënyrë të diferencuar, të padrejtë dhe të pafavorshme, ankuesen, J. M., për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, duke sjellë për pasojë diskriminimin e saj, përsa i takon përjashtimit nga frekuentimi i Palestrës Ladies Gym.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankuesja, J. M., në referencë të dispozitave të posaçme të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, është ekspozuar para veprimeve diskriminuese nga ana e administratorit të Palestrës Ladies Gym.

¹⁸ <https://www.interights.org/vejdeland/index.html>

¹⁹ *Identoba and Others v. Georgia, X and Others v. Austria, B. v. France*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të J. M., për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, nga ana e administratorit të Palestrës Ladies Gym, Tiranë, A. K., lidhur me përjashtimin e saj nga frekuentimi i Palestrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Identiteti gjinor dhe orientimi seksual)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)